



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:226978
Datë: 31.10.2024
Numri i dokumentit: 06383087

KF.nr.266/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, dhe me zyrtaren ligjore Arta Hyseni, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “Universi PN” ShPK, me numër unik identifikues 810839566, dhe me seli në Rr. Pashko Vasa nr.18, Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti, vlerësim tatimor, vlerë kontesti 127,033.10€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 09.10.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Naim Spahiu, avokat nga Prishtina, dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Artan Krasniqi, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Universi PN” ShPK, me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.221/2021 i datës 13.09.2021.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin, “Universi PN” ShPK ta liroj nga ngarkesa me detyrime tatimore në emër të Tatimit në të Ardhura të Korporatave për periudhën 2017-2019, si dhe nga ndëshkimet administrative në shumë prej 25,407.02€, në vlerë të përgjithshme prej 127,033.10€ (njëqind e njëzet e shtatë mijë e tridhjetë e tre euro e dhjetë cent), në afat prej 15 ditësh nga nxjerrja e këtij aktgjykimit.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 11.10.2021, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e

vendimit nr.221/2021 të datës 13.09.2021 për shkak se nuk janë aplikuar fare apo nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore, për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike apo nga faktet e vërtetuara është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së parimeve të procedurës administrative. Pas elaborimit në detaje të pretendimeve në padi, i propozon gjykatës që pas administrimit të të gjitha provave materiale të merr aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, të anulohet vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës – Divizioni i Ankesave nr.221/2021 i datës 13.09.2021 dhe të detyrohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës që paditësin “Universi PN” ShPK, me seli në Prishtinë, ta liroj nga tatimi shtesë dhe ndëshkimet administrative, të ngarkuara në raport të kontrollit dhe të konfirmuara me vendimi e Departamentit të Ankesave nr.221/2021 i datës 13.09.2021, të cilat kanë derivuar nga mosnjohja e shpenzimeve të biznesit për Tatim në të Ardhura të korporatave, vitin 2017 në vlerë prej 315,220.58€, për vitin 2018 në vlerë prej 352,443.00€, si dhe për vitin 2019 në vlerë prej 348,617.24€. Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadije duke shtuar se vendimi i të paditurës duhet anuluar pasi që me prova të ofruara në gjykatë dhe të dorëzuara pranë të paditurës mund të vërtetohet lehtësisht se vendimi kontestues është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. E paditura sipas raportit të kontrollit e ka ngarkuar me tatim shtesë paditësin si rezultat i mosnjohjes së shpenzimeve të biznesit në pasqyrën e të ardhurave për tatim në të ardhurave të korporatave për vitin 2017 në vlerë prej 315.220.58€, për vitin 2018 në vlerë prej 352,443.00€ si dhe për vitin 2019 në vlerë prej 348,617.24€ me arsyetimin e përgjithshëm në vendimin kontestues se nuk janë cekur vlera dhe lloji i shërbimeve në kontratën për bashkëpunim të cilën paditësi e ka lidhur me subjektin “German PH” D.O.O me seli në Shkup të Maqedonisë Veriore. Paditësi konsideron se paditura me kontroll si dhe me vendimin kontestues të konfirmuar nga DA me refuzimin e ankesës së paditësit nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore tatimore në fuqi, prandaj bazuar në dispozitat ligjore mund të vërtetohet saktë që funksionet tjera udhëheqëse janë mbuluar nga Maqedonia e Veriut duke filluar nga drejtori përgjithshëm i kompanisë, nga menaxheri i marketingut, menaxheri financiar, menaxheri i produkteve të përgjithshme, ndihmës menaxheri i kontabilitetit dhe menaxheri i zyrës për Universi PN. Për këto funksionet e kryera stafi i përmendur paguhet nga subjekti German Ph D.O.O me seli në Shkup dhe të gjitha këto shpenzime paditësi i ka paguar sipas faturave të bashkangjitura kësaj padie me specifikacionin e shpenzimeve. Të gjitha këto në vështirësi të dispozitave ligjore të cilat paditësi i ka paguar në Maqedoninë Veriore dhe se nuk mund të tatimohen të njëjtat edhe në Kosovë, krejt kjo bazuar në Marrëveshjen për

Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë të nënshkruar nga shtetet përkatëse. Tutje përfaqësuesi i paditësit në seancën e datës 23.09.2024 e precizon kërkesëpadinë e paditësit në pikën III të saj si në vijim: Detyrohet e paditura ATK që paditësit Universi PN ShPK me seli në Prishtinë ta lirojë nga tatimi shtesë në shumë prej 101,626.08€ dhe ndëshkimi administrativ në shumë prej 25,407.02€ të ngarkuara me raport të kontrollit dhe të konfirmuara me vendimin e DA nr. 221/21 i datës 13.09.2021 të cilat kanë derivuar nga mosnjohja e shpenzimeve të biznesit për tatimin në të ardhura në korporata për vitin 2017 në vlerë prej 315,220.58€, për vitin 2018 në vlerë prej 352,443.00€ si dhe për vitin 2019 në vlerë prej 348,617.24€. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se nga provat e administruara vërtetohet qartë se padia dhe kërkesëpadija është e bazuar andaj qëndron në tërësi pranë padisë dhe dhe precizimit të kërkesëpadijes të datës 23.09.2024 duke shtuar se vendimi i të paditurës duhet të anulohet për shkak se në aktin e atakuar nuk janë aplikuar fare dispozitat ligjore e në veçanti marrëveshja për shmangiet e tatimit të dyfishtë të nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, kjo ka shkaktuar që në procedurën që i ka paraprirë nxjerrjen e aktvendimit kontestues nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës administrative e veçanërisht në vërtetim të drejtë të gjendjes faktike. Nga faktet e vërtetuara në mënyrë të gabuar nga e paditura është nxjerrë përfundim i gabuar, paditësi konsideron se vendimi i atakuar përveç tjerash i mungojnë edhe elementet të detyrueshme të një akti administrativ pasi që me ekspertizë janë vërtetuar në mënyrë të qartë se shpenzimet e faturuar nga kompania German Ph d.o.o me seli në Shkup, të cilat shpenzime janë paguar kompanisë nga Maqedonia Veriore dhe për këto shpenzime është paguar tatimi në Maqedoninë Veriore dhe i njëjti nuk duhet të tatimohet edhe në Kosovë. Prandaj konsiderojmë në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat në fuqi konsiderojmë se vendimi i atakuar është i paligjshëm. Me provat e dorëzuara pranë të paditurës dhe të njëjtat të dorëzuar anë gjykatë vërtetohet se paditësi kërkesëpadinë e ka të bazuar dhe se vendimi kontestues duhet të anulohet andaj i propozojmë gjykatës që padia e paditësit të aprovohet në tërësi, të anulohet vendimi kontestues me nr.221/2021 i datë 13.09.2021 dhe të detyrohet e paditura ATK që paditësit Universi PN të lirojë nga tatimi shtesë dhe nga ndëshkimet administrative të ngarkuara në raport të kontrollit dhe të konfirmuara në vendimin kontestues të cilat kanë derivuar nga mos njohja e shpenzimeve të biznesit TAK për vitin 2017 siç precizuar në seancën e datës 23.09.2024.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 29.04.2022, i kundërshton pretendimet e paditësit në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar ka mbështetje ligjore dhe është në harmoni të plot me legjislacionin tatimor të aplikueshmen në

Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaron se qëndron tërësisht pranë përgjigjes në padi si dhe shkresave tjera të dorëzuara në këtë lëndë. Ndërsa kërkesëpadinë e paditësit e konsideron si të pabazuar dhe e konteston në tërësi. Shton se paditësi ka deklaruar shpenzimet të përgjithshme administrative sipas llojit dhe vlerave të cekura në vitet kontestuese mirëpo sa i përket natyrës së shërbimeve nuk janë dorëzuar dëshmi që të argumentohet se ku kryhen shërbimet. Ndërsa faturat që ka ofruar gjatë procedurës së kontrollit dhe gjatë shqyrtimit të ankesës së paditësit kanë qenë të njëjtat kundërthënëse në mes vete sepse për të njëjtat fatura ka ndryshuar numri i shërbimeve si shembull mund të cekim faturën me nr. 277/17 e të tjera. Derisa shpenzimet nuk janë argumentuar me të drejtë janë konsideruar jo reale dhe nuk janë pranuar. Faturimi është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore nga legjislacioni tatimor. Po ashtu kontrolli ka analizuar përveç këtyre, edhe të hyrat e këtij subjekti tatimor dhe ka konstatuar se të hyrat janë zvogëluar ndërsa shpenzimet janë rritur, gjë që gjatë aktivitetit ekonomik nuk mund të ndodh. Ekspertizën financiare lidhur me këtë lëndë e konsideron të pabazuar, tërësisht të një anshme sepse lidhur me të lartcekurat nuk ka deklaruar asgjë, po ashtu ka deklaruar që ka qenë edhe në Republikën e Maqedonisë, mirëpo nuk ka sjell asnjë dëshmi lidhur me këtë dhe si të tillë kjo ekspertizë nuk paraqet vlerësimet reale të kryera nga e paditura. Më tej ka theksuar se edhe një herë deklarojmë se shpenzimet për periudhat kontrolluese 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë pranuar sepse nuk kanë qenë të cekura në kontratë dhe në faturat e këtyre shërbimeve nuk përshkruhet lloji i shërbimeve dhe çmimi i tyre. Andaj bazuar në fakte në dosjen e kësaj lënde dhe në dispozitat ligjore si dhe vërtetimin e gjendjes faktike dhe interpretimin e drejtë të dëshmive gjykatës i propozon që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet ndërsa vendimi i kontestuar i të paditurës të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 09.10.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi nr.221/2021 dt 13.09.2021, Përgjigje në padi e datë 29.04.2022, Vendim nr.221/2021 i dt 16.08.2021, Raport kontrolli datë 18.05.2021, Raport kontrolli shtesë dt 08.09.2021, Kontratë për bashkëpunim datë 01.06.2015, Marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë nr. 421 datë 07.04.2021, Pasqyrë e të dhënave nga llogaria vjetore për vitin 2020, Analitika për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019, Pasqyrë e të dhënave nga llogaria vjetore për vitin 2018, Analitika për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, Pasqyrat financiare për vitin 2017, 2018 dhe 2019, Analitika për periudhat 01.01.2019-31.12.2019, Vendimi i ZGJONA nr.0518/2021 datë 19.05.2021, Njoftim vlerësimi datë 19.05.2021, Lista me nr. të faturave për vitin 2017, 2018 dhe 2019, Faturë nr. 277/17 e datës

31.12.2017, specifikimi i kostos dhe shumat e tyre, Fatura nr. 04/2018 datë 31.12.2018, nr.38/2019 datë 30.09.2019, Fatura nr.277/17 datë 31.12.2017 (me përshkrim prej 11 pikëve), Faturë nr. 41/2019 datë 31.10.2019 , 46/2019 datë 30.11.2019, 188/17 datë 22.11.2017, 203/17 datë 22.11.2017, 271/17 datë 31.12.2017, 272/17 datë 31.12.2017, 277/17 datë 31.12.2017, 04/2020/D datë 29.02.2020, 06/2020/D datë 29.02.2020, 15/2018 datë 31.12.2018, 22/2018 datë 31.12.2018 dhe faturat tjera të bashkangjitura analitikes, Komunikimi elektronik datë 06.05.2021, 11.05.2021, Alokimet mujore për vitin 2019, 2017 dhe 2018, Njoftim mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim dt 09.12.2020, Vendimi shpjegues publik nr.03/2017, Ankesë e paditësit në DA e datës 23.06.2021, Ekspertizë financiare e datës 11.06.2024, Kundërshtim i ekspertizës financiare e datës 19.09.2024, Ndarja e shpenzimeve sipas fitimit bruto për vitin 2018, 2019 dhe 2017, Faturimi përfundimtar, Pasqyrë e të dhënave nga llogaria vjetore për vitin 2020, Gjendja e llogarisë bankare në Pro Credit Bank e datës 08.10.2021, Formular i deklarimit vjetor për tatimin e të ardhurave të korporatave periudha 2020, 2019, 2018 dhe 2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi me datën 20.11.2020 ka paraqitur pranë të paditurës kërkesën për rimbursim të TVSH-së për periudhën 06/2019 deri 10/2020. Jokontestues mbetet edhe fakti se e paditura me atë 18.05.2021 ka realizuar kontroll tatimor për TVSH për periudhën 04/2017 deri 10/2020 dhe Tatimin në të Ardhura të Korporatave CD për periudhën 2017, 2018 dhe 2019 me ç'rast paditësi është ngarkuar me detyrime shtese në CD në vlerë prej 101,626.08€ dhe ndëshkime në vlerë prej 25,807.61€. Ndaj këtij raporti të kontrollit paditësi ka paraqitur ankesë në ATK e cila me vendimin nr.221/21 të datës 13.09.2021 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 11.10.2021, ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka refuzuar ankesën e

subjektit tatimor këtu paditësit, me arsyetim se Divizioni i Ankesave këtë vendosje-vlerësimin e ka mbështet në nenin 14, 15 dhe 19 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Duke u bazuar në këto dispozita ligjore e paditura nuk i ka njohur shpenzimet që janë krijuar në Maqedoni, të cilat paguhen nga “German PH” DOO dhe të njëjtat janë faturuar subjektit “Universi PH” – këtu paditësi, me pretendimin se kontrata e lidhur në mes të kompanisë “German PX” DOO në Shkup dhe kompanisë “Universi PN” me seli Në Prishtinë, nuk ka të specifikuar llojin e shërbimeve dhe çmimin e tyre. Andaj është vlerësuar se përmbajta e faturave të shërbimeve si shpenzime të përgjithshme administrative për vitet 2017 në vlerë prej 315,220.58€, pastaj për vitin 2018 shpenzimet në vlerë prej 352,443.00€ dhe për vitin 2019 shpenzimet në vlerë prej 348,617.24€, nuk argumentohen apo mbështeten me evidencë, dokument të besueshëm burimor fizik material të vërtet dhe të saktë, nuk dëshmohet fizikisht dhe efektivisht ku kryhen shërbimet rast pas rasti, për faktin se transaksionet nuk janë të argumentuara dhe të paguara për tu pranuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor përkatës, sikurse është paraparë në nenin 23 të Udhëtimit Administrativ nr.15/2010, neni 9 të ligjit nr.05/L-029 dhe neni 13 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2016.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.266/22 të datës 25.03.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar-administrativ me ekspertin financiar Nevruz Oruqi, me detyra përkatëse si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 11.06.2024 ka konstatuar se: Gjatë verifikimit të natyrës së shpenzimeve duke marr parasysh strukturën organizative të kompanisë si dhe ndërlidhjen e tyre më veprimtarinë kryesore të biznesit për periudhat 2017 deri në vitin 2019, me rastin e verifikimit të shpenzimeve të faturuara nga subjekti “German PH” DOO, këto shpenzime janë drejtpërdrejtë të lidhura me aktivitetin ekonomik të paditësit në Kosovë. Duke u bazuar në analizën e informatave të prezantuara, pasqyrave financiare të subjektit “German PH” DOO me seli në Shkup për periudhën 2017-2019 dhe korrespondencën e dokumenteve të deklarimit të tatimeve me Administratën Tatimore të Maqedonisë, subjekti “German PH” DOO i ka deklaruar të hyrat e inkasuara nga paditësi në Administratën Tatimore të Maqedonisë. Eksperti ka verifikuar dhe konstatuar se të hyrat e marra nga paditësi janë deklaruar dhe tatimet janë paguar në përputhje më ligjin në Republikën e Maqedonisë. Shpenzimet për paditësin janë përfshirë në raportimin e të ardhurave në Maqedoni, gjë e cila tregohet përmes pasqyrave

financiare në raportimin e të ardhurave të subjektit “German PH” DOO në Maqedoni, duke shfaqur transparencë në raportimin financiar. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor eksperti financiar ka deklaruar se bazuar në aktvendimin e datës 25.03.2024 mbi përcaktimin e ekspertizës financiare të Gjykatës Komerciale të Dhomave të Shkallës së Parë me KF.nr.266/22. Eksperti financiar për vërtetimin e gjendjes së kërkuar me aktvendimin e gjykatës ka ndërmarrë veprime si më poshtë: 1. Në rastin e ekspertimit kam bërë ekzaminimin e të dhënave nga dokumentacioni financiar dhe dokumentacioni i bashkangjitur në lëndë, si dhe ai i siguruar në procedurën e ekspertimit apo vëzhgimit fizik, 2. Për analizimin e regjistrimeve faturimit apo shpenzimeve për periudhën kontestuese kemi marrë në konsideratë librat e blerjes dhe të shitjes për periudhën kontestuese 2017-2019, 3. Për evidentimin e shpenzimeve operative kemi marrë në konsideratë librat që paditësi ka deklaruar në ATK. Po ashtu kemi analizuar në detaje kartelat bankare të Universi PN, 4. Për shpenzimet e faturuara nga subjekti German PH D.O.O kemi analizuar se shpenzimet nëse kanë të bëjnë me aktivitetin ekonomik të Universi PN, 5. Kemi konstatuar në mënyrë fizike do të thotë kam qenë në shtetin e Maqedonisë së Veriut dhe kam vëzhguar sipas deklaramit të organit tatimor kompetent në këtë shtet nëse subjekt German PH D.O.O i ka deklaruar të hyrat në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Më detajisht e kam sqaruar në faqen 12 pika 5 e ekspertizës financiare.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 11.06.2024 të punuar nga eksperti financiar N.O., në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Gjykata përmes nxjerrjes së provën me ekspertizë financiare dhe nga provat e paraqitura në shkresat e lëndës gjeti se nuk qëndron pretendimi i të paditurës se shpenzimet administrative për vitet 2017 në vlerë prej 315,220.58€, pastaj për vitin 2018 shpenzimet në vlerë prej 352,443.00€ dhe për vitin 2019 shpenzimet në vlerë prej 348,617.24€, nuk argumentohen apo mbështeten me evidencë, dokument të besueshëm burimor fizik material të vërtet dhe të saktë, nuk dëshmohet fizikisht dhe efektivisht ku kryhen shërbimet rast pas rasti, për faktin se transaksionet nuk janë të argumentuara dhe të paguara për tu pranuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor përkatës, sikurse është paraparë në nenin 23 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, neni 9 të ligjit nr.05/L-029 dhe neni 13 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2016. Këtë konstatim të të paditurës gjykata e konsideron si të pabazuar për faktin se nga shkresat e lëndës dhe vlerësimet e ekspertit financiar është konstatuar se paditësi këto shpenzime i ka argumentuar mjaftueshëm duke paraqitur kontratën e lidhur në mes të subjektit “German PH” DOO në Shkup dhe “Univers

PN” ShPK – këtu paditësi. Gjithashtu secilës faturë i është bashkangjitur lista me shërbimet e ofruara për atë faturë dhe është konstatuar fakti se secila faturë është paguar përmes transaksioneve bankare përkatëse. Fakt tjetër i rëndësishëm për vërtetësinë e realizimit të këtyre shpenzimeve është dhe raportimi i tyre si të hyra në pasqyrat financiare të subjektit “German PH” DOO dhe deklarimi i tyre në Administratën Tatimore të Maqedonisë. Ky fakt është konstatuar dhe vërtetuar nga eksperti financiar i cili ka analizuar pasqyrat financiare të këtij subjekti dhe të njëjtat i ka bashkangjitur si prova në shkresat e lëndës.

Gjykata tutje ka analizuar edhe pretendimet e të paditurës në lidhje me kundërshtimet e ekspertizës financiare dhe konstaton se të njëjtat nuk janë të bazuara për faktin se Fatura nr.277/17 e datës 31.12.2017 është rigjeneruar me kërkesë të inspektorit gjatë kontrollit, pasi që është kërkuar të ofrohen informata më të detajuara lidhur me shërbimet të cilat janë ofruar për të cilat është aprovuar. Ndryshime nuk ka pasur në vlerë në këtë faturë por vetëm në shërbime. Prandaj vetëm është rigjeneruar fatura, pra nuk është lëshuar dy herë. Ndërsa lidhur me pretendimin se fatura nr.11/17 e datës 17.11.2017 nuk është regjistruar në librin e shitjes, për këtë faturë gjykata konstaton se as raporti i kontrollit nuk e ka konsideruar si shkelje ligjore pasi kjo faturë është deklaruar në CD të vitit 2018, siç edhe ceket në raportin e kontrollit në faqe 13. Kjo faturë me kontrole është marrë si e hyrë për periudhën dhjetor 2018 bazuar në ligjin nr.05/L-037 sipas nenit 38 par.2 duke mos ndryshuar të hyrat për TAK.

Gjykata ka shqyrtuar bazën ligjore në të cilën është mbështetur e paditura me rastin e mosnjohjes së shpenzimeve administrative për vitin 2017, 2018 dhe 2019 dhe konstaton se në nenin 23 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 në paragrafin 1 parashihet që “ 1. *Sikurse është paraparë në legjislacionin tatimor përkatës, tatimpaguesit i lejohet të zbresë nga të ardhurat bruto ato shpenzime të paguara apo të ndodhura gjatë periudhës tatimore që lidhen me veprimtarinë ekonomike në atë periudhë nëse këto shpenzime në tërësi apo pjesërisht janë në lidhje me veprimtarinë ekonomike të kryer gjatë periudhës tatimore. Ngjashëm, një tatimpaguesi i lejohet një kreditim në një deklaratë tatimore në përputhje me legjislacionin e TVSh-së në fuqi. Për tu lejuar shpenzimet/kreditimet e tilla, duhet të mbështeten me evidencë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në sa vijon: 1.1. faturat në të cilat duhet të paraqitet numri fiskal i shitësit/ofruesit 1.2. kontratat; 1.3. deklaratat e doganës, nëse janë të shoqëruara me dokumentacion që provon koston dhe pronësinë e artikullit(ujve) të importuar; 1.4. kuponët në të cilat duhet të paraqitet numri fiskal i shitësit/ofruesit; 1.5. dokumentet e pagesës; 1.6. dokumentet bankare; 1.7. regjistrimet e listës së pagave; 1.8. biletat; 1.9. dëftesat; 1.10. urdhër*

transferet; 1.11. dokumente tjera përkatëse". Rrjedhimisht në harmoni me këtë dispozitë ligjore paditësi ka paraqitur faturën në të cilën është shënuar numri fiskal, transfarin bankar, përkatësisht dokumentin e pagesës, kontratën e lidhur me subjektin "German PH" DOO, listën e shërbimeve të ofruara për secilën faturë dhe dokumentacion tjetër mbështetës përtej kërkesave ligjore. Në nenin 9 të Ligjit nr.05/L-029, në paragrafin 1 është paraparë që *"Në varësi të kufizimeve të këtij ligji, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit."* Prandaj gjykata mbështetur në kontratën e lidhur mes palëve, listën e shërbimeve të ofruara dhe vlerësimin e ekspertit financiar të dhënë në ekspertizën e datës 11.06.2024, konstaton se shpenzimet administrative të paditësit për vitet 2017, 2018 dhe 2019 janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me aktivitetin ekonomik të paditësit.

Tutje, Gjykata ka analizuar edhe dispozitat ligjore të cilat lidhën me Marrëveshjen për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë e datës 07.04.2011, për të cilat e paditura nuk ka dhënë asnjë sqarim në vendimin kontestues se perse nuk i ka marr për bazë të njëjtat. Në nenin 7 paragrafi 3 të kësaj marrëveshje është paraparë që *"Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme do të lejohen si zbritje shpenzimet që kanë ndoshur për qëllime të selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të ndodhura kësisoj, si në shtetin ku ndodhte selia e përhershme ashtu edhe gjetkë"*. Ndërsa në nenin 22 paragrafi 1 të kësaj marrëveshje thuhet se *"Kur një rezident i një shteti kontraktues realizon të ardhura ose zotron kapital i cili në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshje, mund të tatonet në Shtetin tjetër kontraktues, shteti parë i përmendur do të lejoj: një zbritje nga tatimi në ta ardhurat e atij rezidenti, në një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguara në këtë shtet tjetër, një zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, në një shumë të barabart me tatimin mbi kapitalin e paguar në shtetin tjetër"*. Në dritën e këtyre dispozitave ligjore gjykata konstaton se bazuar në pasqyrat financiare të kompanisë "German PH" DOO dhe vlerësimeve të ekspertit financiar, shpenzimet e paguara nga paditësi për subjektin "German PH" DOO, janë trajtuar nga ky subjekt si të hyra dhe për këto të hyra është paguar tatimi në Maqedoninë e Veriut.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, ballafaqimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të vendimit kontestues, gjykata vlerësoi se organi i paditur ATK-së ka

nxjerr konkluzion jo të drejt në pikëpamje të gjendjes faktike kur ka konstatuar se shpenzimet administrative për vitin 2017, 2018 dhe 2019 të realizuara nga paditësi, nuk mund të pranohen pasi që të njëjta nuk janë të argumentuara dhe nuk janë në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, prandaj Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43, par 3 dhe 46 par. 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, anuloi vendimin kontestues dhe e detyroj të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin Universi PN” ShPK ta liroj nga ngarkesa me detyrime tatimore në emër të Tatimit në të Ardhura të Korporatave për periudhën 2017-2019, si dhe nga ndëshkimet administrative në shumë prej 25,407.02€, në vlerë të përgjithshme prej 127,033.10€ (njëqind e njëzet e shtatë mijë e tridhjetë e tre euro e dhjetë cent), në afat prej 15 ditësh nga nxjerrja e këtij aktgjykimit.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 përcaktohet se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*, ndërsa me nenin 7 par 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet*

ta realizojë në procedurën kontestimore”.

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi, kundërshtimin e ekspertizës dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Kjo për faktin se paditësi pretendimet e veta siç u vlerësuar edhe më lartë i ka të bazuara në fakte, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për tu njohur si të tilla.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka marr konform nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.266/22 datë 09.10.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.